# KONTRATE SHITJEJE

**Ndermjet**

z. Daniel ISRAEL
Avenue des Nations Unies, 1A
KINSHASA - ZAIRE

z. David FERNANDEZ
Avenue des Aviateurs
KINSHASA - ZAIRE
perfaqesuar nga D.ISRAEL

te quajtur pale e pare

**Dhe**

DANISMAC S.A.
Shoqeri anonime
3B, Boulevard du Prince Henri
L-1724 LUKSEMBURG
R.C. Luksemburg B 29.850

e quajtur pale e dyte,

te cilet rane dakort si me poshte:

**Neni 1**

Pala e pare deklaron me kete kontrate veprimin e shitjes pales se dyte, e cila pranon me çmimin dhe kushtet e meposhtme objektin e shitjes, qe pershkruhet ne vijim dhe i te cilit ata deklarojne te jene pronare te vetem:

75% te kapitalit te shoqerise ALBECORP, Rruga S.Frasheri, Pall.13, Ap.2, TIRANE - SHQIPERI, 50% te se cilit i takojne zotit D.Israel dhe 25% zotit D.Fernandez.

Keto aksione jane te lira nga hipotekimi dhe uzufrukti. Ato shiten me te drejten per marrjen e fitimit nga veprimtaria ne vazhdim. Pala e dyte do te gezoje te drejtat trashegimore qe nga data e ketij akti shitjeje.

**Neni 2**

Kjo shitje do te behet ne baze te ligjeve duke paguar shumen prej 3000 (tre mije) dollare amerikane.
Kjo shume do te paguhet jo me vone se data 31.12.1997.

**Neni 3**

Levrimi i objektit te shitjes do te behet pas marrjes nga pala e pare te shumes se siperpermendur.

**Neni 4**

Pala e dyte pranon qe ka dijeni te plote per statutin dhe gjendjen financiare te shoqerise ALBECORP dhe ajo formalisht shkarkon palen e pare nga dhenia e çfaredo informacioni ne lidhje me keto.

**Neni 5**

Te gjitha shpenzimet qe rrjedhin prej ketij akti shitjeje do t´i takojne ekskluzivisht pales se dyte. Per çmimin e blerjes te fiksuar ne nenin 2 te siperpermendur eshte rene dakort mes dy paleve.

**Neni 6**

Dispozitat e kesaj kontrate jane te pandashme ashtu si dhe objekti i saj. Anullimi apo shfuqizimi i nje detyrimi te kontrates çon domosdoshmerisht ne zgjidhjen e saj.

**Neni 7**

Kontrata ne fjale eshte hartuar ne baze te ligjit luksemburgez.
Palet bien dakort qe te gjitha mosmarreveshjet qe lindin prej kesaj kontrate apo jashte zbatimit te saj t´ia paraqesin nje kolegji arbitrash te ngritur ne perputhje me Kodin e Procedures Civile te Luksemburgut, vendimet e te cilit jane vendimtare dhe te formes se prere.

Bere ne dy kopje ne Luksemburg, me 30 korrik 1997.

Çdo pale pranon te kete marre kopjen e saj origjinale.

Shitesi

Bleresi

D.ISRAEL D.FERNANDEZ

DANISMAC S.A.
perfaqesuar nga D.ISRAEL Administrator,Administrator

PERKTHYESE

FLUTUR LAKNORI
Translation office
ITALIAN, FRENCH, ENGLISH, RUSSIAN ...
Tel/Fax: 355/42/62113, ...
TIRANA ALBANIA